



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .01.2025

MBLEDHJA Nr. 04,
Datë 16.01.2025, ora 09:30
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e enjte, datë 16.01.2025, ora 09:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 04, e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Bordit të ERE-s më datë 06.01.2025.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “SAMASOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “REBESOL” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi unifikimin e burimit për çmimin e energjisë elektrike që do të merret për referencë në përlllogaritjen e mbështetjes financiare, që duhet të dokumentojnë në ERE subjektet që aplikojnë për t’u pajisur me licencë për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike.
6. Mbi dhënien e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar në muajin tetor 2024 nga parku fotovoltaik “Blue 1”, i shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “GEN-I TIRANA” sh.p.k. për rishikimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 241, datë 15.11.2024.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI